

KËRKESË
Nr.1753, datë 13.6.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIMIN ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “ALKIDA HYSEJNI”

ISHSH-JA, Dega Rajonale e qarkut Tiranë, meqënëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar “objekt i pakërkuar” (Porta gjithmonë mbyllur).

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale e qarkut Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH-TR-2019-002012-5, datë 1.6.2019, për subjektin Alkilda Hysejni me nr. NIPT-i L51601005M, me adresë: Njësia Bashkiake nr 6, rruga Kavajës, ish-fabrika konjakut, kati 2, Tiranë.

KRYEINSPEKTOR
Gjergji Koja

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-TR-2019-002012 - 5

Datë 1.6.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 241, datë 27.3.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-TR-2019-002012-2, datë 1.6.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin Alkilda Hysejni, me NIPT L51601005M, përfaqësues i autorizuar i subjektit Refuzon, prej datës 1.6.2019 deri më datën 1.6.2019.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datë 1.6.2019 dhe e njoftoi më datën 1.6.2019. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006, i ndryshuar, neni 15/1 dhe 16, pika “d”.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit, neni 20/1, pika “e”, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjohë 300 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave.

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Evald Bejaj

ID_



Bardhyl Poga

ID_0401010004



Ermal Ibrahim

ID_0401080010



Johana Sinani

ID_0401070008



Personi i autorizuar i subjektit

Refuzon firmën

Refuzon



Kundër Vendimit Përfundimtar të inspektimit, subjekti **Alkilda Hysej**ni ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar.

Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror” të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.